



VENDIM

Nr.25 Datë 11.02.2015

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “ ANIO OIL& GAS ” SH.A. NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR PËR NJË
AFAT 5 VJECAR.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, gërma “ç”, si dhe neni 4, pika 1, gërma “ç”; neni 8, neni 9 pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, “d” “e”; pika 2, gërma “e” dhe nenin 10 pika 1 dhe pika 11 të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror,” miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, date 11.02.2011; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ANIO OIL & GAS sh.a”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ANIO OIL & GAS sh.a”, për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie ,plotëson tërësisht kërkesat e

parashikuara nga ERE;

Dokumentacioni i Përgjithshëm ;

Nenin 9, pika 1 , gërma (a,b,c) (Formati i aplikimit plotësuar në mënyre korrekte) dhe neni 9, pika 1, gërma (d/i,d/ii) (Dokumentacioni ligjor,administrativ dhe pronësorë), është plotësuar në mënyre korrekte.

Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale ;

Neni 9,pika 1,gërma e/V (Pagesës së aplikimit në ERE), Neni 9,pika 1, gërma e/Vi (Plan biznesi), Neni 9, pika 1, gërma e/i (Sigurimet shoqërore dhe Tatim-Taksat), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “ANIO OIL & GAS sh.a.në aktivitetin e tregimit të gazit natyror për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI